



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 tetor 2023
Nr.ref.: RK 2280/23

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI78/23

Parashtruese

Maliqe Sopjani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 339/22 të Gjykatës
Supreme të Kosovës, të 7 nëntorit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar, dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Maliqe Sopjani me vendbanim në fshatin Harilaq, Komuna e Fushë Kosovës. Parashtruesen e kërkesës e përfaqëson Ekrem Agushi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 339/22] të 7 nëntorit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës.
3. Aktgjykimi [Rev. nr. 339/22] i 7 nëntorit 2022 i Gjykatës Supreme, i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 9 dhjetor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 339/22] të Gjykatës Supreme të 7 nëntorit 2022, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 31 paragrafi 2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 113 paragrafi 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 (Procedimi i kërkesës) dhe nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatë

7. Më 5 prill 2023, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 13 prill 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR.KI78/23], caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues, ndërsa përmes Vendimit [Nr. KSH.KI78/23] caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha, anëtarë.
9. Më 24 prill 2023, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtrueses së kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë kërkesën duke specifikuar qartë dhe elaboruar në detaje shkeljet e pretenduara të neneve të Kushtetutës.
10. Më 5 maj 2023, Gjykata pranoi një shkresë nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, në të cilën i njëjti vetëm specifikon se i konteston nenet 31, 46, 52 dhe 117 të Kushtetutës, por nuk ofron informacione e as nuk elaboron qartësisht shkeljet e pretenduara të këtyre neneve dhe lidhshmërinë që të njëjtat kanë me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, përveç se përshkruan dispozitat kushtetuese të

neneve të lartcekura. Gjithashtu, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës në këtë shkresë kishte theksuar se *“Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës se “Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike” është plotësisht i gabuar. ... pronësore e ka paraqitur në Drejtorinë për Çështje Pronësore dhe Banesore në Prishtinë më 11.04.2003. Ky fakt vërtetohet me shikimin e vendimit të së njëjtës drejtori, numri i kërkesës”, e që për Gjykatën mbetet i paqartë kuptimi dhe lidhshmëria e kësaj pike të shkresës në rastin konkret.*

11. Më 24 maj 2023, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.
12. Më 29 gusht 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

13. Gjykata në fillim të përmbledhjes së gjendjes faktike vëren se esenca e procedurës pranë gjykatave të rregullta ka të bëjë me vërtetimin e së drejtës pronësore mbi banesën me sipërfaqe prej 84.11 m2, e cila ndodhet në Lagjen “Dardania”, SU-9/1, L.1, nr. 33 në Prishtinë, të cilën, sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Korporata Energjetike e Kosovës S.H.A. (në tekstin e mëtejme: KEK), ia kishte ndarë bashkëshortit të saj tani të ndjerë.
14. Me qëllim të vërtetimit të së drejtës pronësore mbi banesën në fjalë, parashtruesja e kërkesës ka zhvilluar dy procedura, përkatësisht, **i**) procedurën pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) dhe **ii**) procedurën pranë gjykatave të rregullta.
15. Gjykata gjen se procedura e parë pranë AKP-së përfundoi me Vendimin e shkallës së parë [HPCC/D/110/2004/A&C] të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejme: DÇPB) të 13 shkurtit 2004. Në këtë vendim, DÇPB refuzoi kërkesën e saj për kthimin në posedim të banesës në fjalë. Kundër vendimit të shkallës së parë, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Komisionin për Shqyrtim të Ankesave, i cili, më 31 mars 2006, nxori Vendimin HPCC/REC/60/2006, me të cilin e refuzoi ankesën e saj si të pabazuar.
16. Procedurën e dytë gjyqësore, parashtruesja e kërkesës e inicioi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), kronologjinë e së cilës gjykata do ta prezantojë në vazhdim të këtij Vendimi.

Procedura pranë gjykatave të rregullta

17. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës së bashku me paditësit B.M, B.M dhe B.M (fëmijët e saj) (në tekstin e mëtejme: paditësit e tjerë), kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore kundër KEK-ut, duke kërkuar që t'i njihet e drejta e pronësisë mbi banesën në Lagjen “Dardania”, SU-9/1, Lam. 2, numër 33, kati 8, në Prishtinë, me sipërfaqe prej 84.11 m2, si dhe që e paditura KEK të lejojë që paditësit këtë të drejtë ta regjistrojnë në pronësi të përbashkët të tyre.
18. Në padinë e saj, parashtruesja e kërkesës së bashku me paditësit e tjerë kishte pretenduar se personi J.M (bashkëshorti dhe babai i tyre) ka qenë punëtor i të paditurës KEK për 17 vite deri në vitin 1990 kur është larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme. Gjatë kësaj marrëdhënie të punës, siç kishte theksuar parashtruesja e kërkesës së bashku me paditësit e tjerë, më 15 shtator 1989, me Vendimin numër 1991 të marrë nga Këshilli i Punëtorëve më 7 shtator 1989, personit J.M i ishte ndarë

banesa me sipërfaqe prej 84.11 m2 në Lagjen Dardania, SU-9/1, Lam. 2, nr. 33. Pasi personi J.M kishte tentuar të vendoset në këtë banesë, përkatësisht më 8 korrik 1992, ka vërejtur se në të njëjtën kohë ka hyrë në posedim personi S.T, i cili i kishte komunikuar se ndërmarrja e paditur (KEK) ia kishte shitur atij banesën në fjalë.

19. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata gjen se çështja e njëjtë tashmë ishte vendosur njëherë nga Gjykata Themelore, por e njëjta ishte kthyer sërish nga Gjykata e Apelit në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
20. Më 18 dhjetor 2017, Gjykata Themelore gjatë procedurës së përsëritur nxori Aktgjykimin [C. nr. 1497/11], përmes të cilit **(i)** e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës dhe paditësve të tjerë; si dhe **(ii)** vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta.
21. Në arsyetimin e Aktgjykimit [C. nr. 1497/11], Gjykata Themelore *inter alia* deklaroi:

“...duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqenëse tek palët nuk ishte kontestuese se paraardhësit të paditësve i është ndarë banesa kontestuese (...), i cili është udhëzuar po ashtu që të lidh kontratë me BVI-në në Prishtinë, lidhur me të njëjtën banesë si organizatë e cila ka bërë menaxhimin e paluajtshmërisë kontestuese, mirëpo në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë dëshmi me të cilën do të dëshmonte lidhjen e saj, e që sipas ligjeve në fuqi të asaj kohe, si një ndër kushtet për fitimin e të drejtës banesore ka qenë edhe lidhja e kontratës.”

“Konform nenit 37 të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore, përcaktohet se, “kontrata mbi shfrytëzimin e banesës lidhet në mes personit, i cili ka marrë banesën për shfrytëzim dhe bashkësisë vetëqeverisëse të interesit për banim, në bazë të aktit të dhënësit të banesës për shfrytëzim”, ndërkaq në paragrafin 2 të këtij neni kërkohet edhe ekzistimi i kontratës formale, e në këtë rast kontrata nuk është lidhur në mes përfituesit të banesës dhe Elektroekonomisë, si paraardhësve e të paditurës KEK me seli në Prishtinë, andaj edhe kushti i dytë nuk është plotësuar.”

“Po ashtu, për fitimin e të drejtës banesore sipas nenit 11 të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore, kushti i tretë ka qenë edhe vendosja e ligjshme, apo hyrja në banesë, ndërkaq paraardhësi i tani paditësve, nuk ka bërë hyrjen në banesën e ndarë për të, e që me këtë rast dispozitat ligjore kanë përcaktuar qartë se për fitimin e të drejtës banesore, në mënyrë kumulative duhet të plotësohen tri kushtet e përcaktuara më lartë për fitimin e të drejtës banesore.”

“Rrjedhimisht në rastin konkret gjykata duke zbatuar dispozitat e nenit 11 dhe 37 të Ligjit për Marrëdhënie Banesore (i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e dhënies së banesës në shfrytëzim), e refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.”

22. Parashtruesja e kërkesës dhe paditësit e tjerë kishin paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit [C. nr. 1497/2011] të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 20 prill 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 2221/18] e kishte, **(i)** refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës së bashku me paditësit e tjerë; dhe kishte **(ii)** vërtetuar Aktgjykimin [C. nr. 1497/11] e Gjykatës Themelore të 18 dhjetorit 2017.

24. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit ishte pajtuar me qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë, ndërsa sa i përket pretendimeve tjera ankimore kishte theksuar se, *“nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësve për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm (...) Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes (...), po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërrthënie, në ndërkohë që kundërrthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.”*
25. Parashtruesja e kërkesës dhe paditësit e tjerë kishin paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme), për shkak të: **(a)** shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe **(b)** zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që **(i)** Gjykata Supreme ta prishë aktgjykimin e shkallës së dytë dhe **(ii)** çështja t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.
26. Më 7 nëntor 2022, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Rev. nr. 339/22], me të cilin e refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesja e kërkesës dhe paditësit e tjerë kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 2221/18] të Gjykatës së Apelit të 20 prillit 2022.
27. Në arsyetimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 339/22], Gjykata Supreme e kishte pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe asaj të shkallës së parë, ndërsa pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore i kishte vlerësuar si të pabazuara. Lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, Gjykata Supreme kishte theksuar se, *“Paditësit në këtë rast nuk kanë arritur t'i vërtetojnë faktet mbi të cilat e mbështesin kërkesën e tyre edhe pse kjo ka qenë detyrë e tyre, në kuptim të nenit 322, paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 7 paragrafi 1 dhe 319 paragrafi 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare (...) Për të pasur sukses në kërkesëpadinë pala paditëse është dashur që të argumentoi me prova konkrete se janë pronar të paluajtshmërisë-banesës, në këtë rast të paluajtshmërisë kontestuese, çka nuk kanë arritur të argumentojnë se paraardhësi juridik i tyre, ka qenë pronar i sendit (...)”*, kurse për vërtetimin e gjendjes faktike kishte vlerësuar se, *“Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësit nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2 të LPK-së, përcaktohet se, “Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.”*

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

28. Përfaqësuesi i parashtruese së kërkesës në kërkesën e parashtruar para Gjykatës, pretendoi se Gjykata Supreme ka nxjerrë Aktgjykimin [Rev. nr. 339/22] të 7 nëntorit 2022, në shkelje të të drejtave të parashtrueses së kërkesës, por nuk kishte specifikuar qartë dhe sqaruar në detaje se cilat janë ato të drejta të garantuara me Kushtetutë apo cilat janë nenet e pretenduara Kushtetutës, të cilat ishin shkelur nga gjykatat e rregullta. Pretendimet e përshkruara në kërkesë ishin të gjitha në baza ligjshmërie dhe Gjykata vëren se të njëjtat ishin përshkruar nga revizioni që kishte paraqitur në Gjykatën Supreme.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i kishte dërguar një shkresë përfaqësuesit të parashtrueses së kërkesës, nga i cili kishte kërkuar që të specifikojë qartë dhe në detaje se cilat të drejta të garantuara me nenet respektive të Kushtetutës pretendohet se i janë shkelur parashtrueses së kërkesës.

30. Më 5 maj 2023, Gjykata kishte pranuar një shkresë nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës ku ai kishte përmendur disa nene të Kushtetutës, por pa dhënë elaborimin në detaje dhe arsyetimin e kërkuar nga Gjykata për shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me nenin 113 paragrafi 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], nenin 31 paragrafi 2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nene këto që janë specifikuar në shkresën e lartcekur.
31. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 113 në ndërlidhje me nenin 31, përfaqësuesi i parashtrueses thekson se: *“Sipas vlerësimit të autorizuarit të paditëses, autoriteti publik – gjykatat e cekura më lartë kanë shkelur dispozitën e nenit 113 (7) të Kushtetutës së R. Kosovës me të cilën është parashikuar se “individët janë të autorizuar ti ngritin shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuar me kushtetutë, mirëpo pasi që të kenë shtjerr të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”. Ky interpretim për më tepër se kaq është joprofesional dhe në këtë mënyrë të paditurit i janë shkelur rëndë të drejtat nga neni 31 (2) të Kushtetutës së R. Kosovës e cila garanton se “çdo kush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.”*
32. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 46, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës thekson se: *“Paditësi nëpërmes të autorizuarit të tij konsideron se Gjykata Supreme e Kosovës gjatë procedurës së zhvilluar me revizionin e të paditurës ka bërë shkelje të drejtës së garantuar me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila ka të bëjë me mbrojtjen e së drejtës së pronësisë si e drejtë themelore e garantuar me Konventën Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut me Protokollin e saj. (...) Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës se “Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike” është plotësisht i gabuar.”*
33. Ndërsa, sa i përket nenit 53 të Kushtetutës, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës vlerëson se: *“Neni 53 i Kushtetutës përcakton zbatimin e drejtpërdrejtë të GJEMDNJ. Pasi që paraqitësi i kërkesës saktëson qartë dispozitat kushtetuese dhe të drejtat e tij të garantuara me kushtetutë dhe Konventën Evropiane, kërkon nga Gjykata Kushtetuese të R. Kosovës që të pranoj këtë rast dhe të shqyrtoj kërkesën në pajtim me përmbajtjen e shkeljeve të pretenduara nga paditësi.”*
34. Përfundimisht, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës potencon se: *“I autorizuari i paditësit konsideron që ka vepruar drejtë, brenda afatit gjyqësor dhe i propozon Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, që kërkesën ta pranoj si të bazuar, këtë në pajtim me deklaratimet e theksuara në kërkesë.”*

Dispozitat përkatëse të Ligjit dhe Rregullores së punës

Ligji

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Rregullorja e punës

Rregulli 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve)

[...]

“2. Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(g) arsyetimin rreth pranueshmërisë dhe meritave të kërkesës; dhe

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.”

Rregulli 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

“(2) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedure të shkurtër në qoftë se:

(a) kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesës ose kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose të qartësojë kërkesën.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

37. Përtej kriterëve të përcaktuara më lart, në vlerësimin nëse parashtruesja e kërkesës i plotëson kriteret për vlerësimin e kërkesës së saj, Gjykata rikujton nenin 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit dhe në vazhdim shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç parashihen në nenin 48 të Ligjit, që përcakton:

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

38. Ndërsa, përveç kriterëve të lartcekura, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kërkesat e rregullit 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të

Rregullores së punës, ku parashihet se kërkesa e parashtruesve duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit/es për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësim; (d) emrin dhe adresën e palës ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin rreth pranueshmërisë dhe meritave të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

39. Në këtë kontekst, sipas paragrafit 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit, që parasheh se nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Në rastet kur palët përkatëse nuk dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Gjykatë apo përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, e njëjta sërish mbetet e paplotë ose e paqartë, bazuar në rregullin 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër.
40. Në rastin konkret, duke u bazuar në elaborimin e mësipërm, Gjykata rikujton se kërkesën e parashtrueses së kërkesës e kishte pranuar më 5 prill 2023, por që nuk ishte specifikuar konkretisht se cila të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë i janë cenuar e as cilat nene të Kushtetutës pretendohet se janë shkelur. Në këtë situatë, marrë parasysh që nuk mund të kuptohet se për cilat të drejta dhe liri themelore, parashtruesja e kërkesës po pretendonte për shkelje e as nuk ishin sqaruar pretendimet e saja dhe lidhshmëria e tyre me nenet përkatëse të Kushtetutës, Gjykata më 24 prill 2023 njoftoi përfaqësuesin e parashtrueses së kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti që të dorëzojë një përmbledhje të qartë të fakteve lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë dhe t'i specifikojë nenet që pretendon se i janë shkelur parashtrueses së kërkesës.
41. Më 5 maj 2023, Gjykata pranoi një shkresë nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, në të cilën i njëjti vetëm specifikon se i konteston nenet 31, 46, 52 dhe 117 të Kushtetutës, por nuk ofron informacione e as nuk elaboron qartësisht shkeljet e pretenduara të këtyre neneve dhe lidhshmërinë që të njëjtat kanë me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, përveç se përshkruan dispozitat kushtetuese të neneve të lartcekura. Gjithashtu, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës në këtë shkresë kishte theksuar se *“Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës së “Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike” është plotësisht i gabuar. ...pronësore e ka paraqitur në Drejtorinë për Çështje Pronësore dhe Banesore në Prishtinë më dt.11.04.2003. Ky fakt vërtetohet me shikimin e vendimit të së njëjtës drejtori, numri i kërkesës”, e që për Gjykatën mbetet i paqartë kuptimi dhe lidhshmëria e kësaj pike të shkresës në rastin konkret.*
42. Për më tepër, Gjykata vlerëson se është treguar mjaft e qartë në kërkesën specifike me të cilën iu është drejtuar përfaqësuesit të parashtrueses së kërkesës për të ofruar informacion procedural dhe substantiv lidhur me faktet dhe procedurën që ishte zhvilluar para Gjykatës Supreme, e që e njëjta është objekt i çështjes para kësaj Gjykate. Megjithatë, Gjykata vëren se përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës me shkresën e dorëzuar nuk ka sqaruar mjaftueshëm shkeljet e pretenduara të neneve të cekura dhe në rrethanat e rastit konkret kërkesa e parashtrueses mbetet e paqartë dhe e paplotë në kuptim të specifikimit të drejtave që pretendohet se i janë cenuar parashtrueses së kërkesës me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

43. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesave, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesave nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata i deklaron këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesve të kërkesave (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, KI121/21, parashtrues *Bajram Hasani*, Vendim për refuzimin e kërkesës i 23 shtatorit 2021, paragrafi 38; KI135/21, parashtrues *Isuf Musliu*, Vendim për refuzimin e kërkesës i 10 shtatorit 2021, paragrafi 35; dhe KI101/21, parashtrues "*N.T.Sh. Morina B*", Vendim për refuzimin e kërkesës i 8 shtatorit 2021, paragrafi 36).
44. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses së kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacionin mbështetës, ashtu siç kërkohet me nenet 21, 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 25 (2) (g) dhe (h) dhe 54 (2) (a) të Rregullores së punës. Prandaj, Gjykata vlerëson se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 25 (2) (g) dhe (h) dhe 54 (2) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 gusht 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radosmir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani